



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR.2 SH.A  
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E AKSIONARËVE TË SHOQËRISË

Nr. 56/11 Prot.,

Tiranë 04/02/2021

VENDIM

Nr. 03 datë 04/02/2021

Sot, më datë 04.02.2021 në zyrat e Rezidencës Studentore Universitare Nr.2, SH.A., u mbajt mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të aksionerëve, me rend dite si më poshtë:

**Rendi i ditës:**

1. Emërimi i Administratorit të Shoqërisë “Rezidenca Studentore Universitare nr. 2 sh.a”, Të ndryshme;
2. Të ndryshme.

Në mbledhje është paraqitur Aksioneri i vetëm i Shoqërisë, Bashkia Tiranë përfaqësuar sipas ligjit nga Kryetari i saj Z. Erion Veliaj. Bashkia Tiranë është zotëruese e aksioneve në masën 100% të kapitalit të Shoqërisë duke krijuar kuorumin e nevojshëm për mbajtjen dhe vendosjen në këtë mbledhje.

Pas shqyrtimit të çështjeve sipas rendit të ditës dhe duke mos pasur pika të tjera për të diskutuar, bazuar në ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, ligjin nr. 7926, datë 20.04.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregëtare”, ligjin 139/2015 “Për qeverisjen vendore”, i ndryshuar, si dhe akteve ligjore në fuqi, Aksioneri i vetëm i shoqërisë,

**VENDOSI:**

1. Të emërojë në detyrën e Administratorit të Shoqërisë “Rezidenca Studentore Universitare nr. 2 sh.a”, znj. Zhanina Dapi, për një mandat të ri prej 3 vitesh.
2. Të autorizojë Drejtorinë Juridike dhe Burimeve Njerëzore për zbatimin e këtij vendimi.
3. Të autorizojë Administratorin të rregjistrojë këtë Vendim pranë QKB.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Aksioneri i Vetëm  
BASHKIA TIRANË  
Erion Veliaj

Kryetar



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË  
REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR.2 SH.A  
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

Nr. 552 / Prot.,  
f

Tiranë 18/01 /2021

VENDIM  
Nr. 01 datë 18/01 2021

“MBI MIRATIMIN E STATUTIT TË NDRYSHUAR TË SHOQËRISË ‘REZIDENCA  
STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 2’ SH.A.”

Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë “Rezidenca Studentore Universitare nr. 2” SH.A., në zbatim të nenit 134 gërma a), nenit 135 pika 1, pika 2 gërma b) dhe pika 3 të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, Statutit të “Rezidenca Studentore Universitare nr. 2” SH.A. , të miratuar me vendim nr.10 datë 04.09.2018 të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë, të Vendimit nr. 01 datë 13.01.2021 të Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë “Mbi përcjelljen për miratim nga Asambleja e Përgjithshme, të ndryshimeve në Statutin aktual të Shoqërisë ‘Rezidenca Studentore Universitare nr. 2’ SH.A.”,

VENDOSI:

1. Të miratojë Statutin e ndryshuar të Shoqërisë “Rezidenca Studentore Universitare Nr. 2” SH. A.
2. Ngarkohet Administratori i Shoqërisë “Rezidenca Studentore Universitare nr. 2” SH.A., të kryejë procedurat e parashikuara nga neni 43 i Ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, i ndryshuar.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

KRYETAR

ERION VELIAJ